



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: Projektim për objektin: Rikonstrukcion shkolla të mesme të përgjithshme 9 vjecare dhe fusha sportive.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 71221000-3 - Shërbim për projektim ndertesash

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,833,332 (një milion e tetëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Shkodër** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:
 - a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10
 - b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i

vetëdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përllogaritur të kontratës/lotit e konkretisht **733,332** (Shtatëqind e tridhjetë e tremije e treqind e tridhjetë e dy) lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik””*Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.”*, si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik””*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet*

operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetary.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **733,332** (Shtatëqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë që është 40% e vlerës së fondit limit lotit dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 55, pika 4, ”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogarit të kontratës/lotit, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa c), për procedurat nën kufirin e ulët monetar, siç është rasti i kësaj procedure.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas

afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotit, që prokurohet dhe konkretisht **366,666** (Treqind e gjashtedhete e gjashtemije e gjashteqind e gjashtedhete e gjashte) lekë.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77” Kerkesat per kualifikim”, te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4, *ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren si dhe në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar*

duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është nën kufirin e ulet monetar, vlera për shërbime të ngjashme prej **366,666** (Treqind e gjashtedhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e gjashtedhjetë e gjashtë) lekë përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parasysh objektin dhe vlerën e kontratës dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Vlera e kërkuar nuk sjell kufizim të konkurrencës dhe është në masën 20% të fondit limit.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:

2. PROJEKTUES ARKITEKT

- b-1), objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara;
- b-2), qendra tregtare; objekte social-kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;

3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR

- a) Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.

4. PROJEKTUES INSTALATOR

- a) Projektim të instalimeve hidro-termosanitare;
- b) Projektim të instalimeve termoteknike- kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme;
- c) Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale;
- f) Projektim të sistemeve kundër zjarrit;
- j) Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, akses kontroll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit, etj., për objektet civile dhe industriale.

5. PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE

- b) Projektim furnizim me ujë – kolektorë shkarkimi.

c) Ujesjelles kanalizime urbane-rurale

8.PROJEKTUES GJEODET

a-Rilevime inxhinierike

10.PROJEKTIMI I IMPIANTËVE TË PRODHIMIT DHE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

e) Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës – linja të tensionit të ulët – të mesëm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifike te percaktuara ne termat e references.

Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas deryres se projektimit.

Autoriteti Kontraktor për vendosjen e këtyre licensave është bazuar në Detyren e Projektimit, i cili do te permbaje:- projektin konstruktiv; projektin e instalimeve hidroteknike; projektin e instalimeve elektrike; projektin e instalimeve të pajisjeve/makinerive;projektin e linjës teknologjike;projektin e sistemimit të jashtëm, të instalimeve jashtë objektit dhe lidhjen me rrjetin e kryesortë instalimeve, arkitekturën e peizazhit dhe hortikulturën etj

2.3.3 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të ketë të punësuar staf inxhinierik si drejtues teknik në licencen e shoqërisë për realizimin e shërbimit sa më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik;

Për stafin sa më sipër duhet të paraqitet: kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Liçenca profesionale individuale, si dhe duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë per te pakten muajin e fundit

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e referencës

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

Ing elektrik nevojitet të rishikojë të gjithë informacionin ekzistues lidhur me gjendjen aktuale të ndricimit dhe projekti të jetë i realizuar që të arrijë standartin e kërkuar për realizimin e rrjetit elektrik të brendshëm dhe të jashtëm

Ing ndertimit nevojitet për verifikimin e gjendjes aktuale të nderhyrjeve në tarrace, shtresave, rikonstruksionit dhe nderhyrjeve të brendshme dhe të jashtme.

Ing mekanik nevojitet për realizimin e projektit të ngrohjes dhe të sistemit të mbrojtjes nga zjarri.

2.3.4 Operoret ekonomik për realizimin e shërbimit duhet të paraqesin staf ndihmes ose të kontraktuar me kontratë noteriale pune si më poshtë:

- 1 (nje) Arkitekt;
- 1(nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh.

Për stafin sa më sipër duhet të paraqitet: kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Liçenca profesionale individuale, CV.

Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e referencës

Meqenese parashikohen të kete punime në fasaden e jashtme dhe punime të brendshme ndarje hapësirash gjykohet e nevojshme prania e nje arkitekti.

Inxhinieri hidroteknik nevojitet pasi në objekt parashikohen të kete nevojë për rrjet ujësjellesi të ri të brendshëm impiantet e brendshme të ujit etj

1 (një) Inxhinier IT/Telekomunikacion/Elektronik/Sistemesh nevojitet pasi ne objekt parashikohen te behen punime ne rrjetin e kablllove televiziv,citofonise ,kompjuterave dhe videombikqyerjes.

2.3.5 Një punësim mesatar i të paktën **5 (pesë)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve.

b) Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjisllacioni në fuqi për për muajin e fundit. *Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqine punetore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

Eshte kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqise punetore minimale te kerkuar argumentojme se jemi bazuar ne sherbimet e kerkuara sipas Termave te References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

Argumentimi: Eshte vendosur kjo kerkese bazuar ne njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale

të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".